



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Vushtri shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Hartografisë dhe GIS
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për GIS, hartografi dhe bazës së të dhënave
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	GJ36-4.95
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	14/02/2024
Afati për aplikim	15/02/2024 - 15/03/2024
Institucioni	Komuna Vushtri
Departamenti	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Divizioni	Sektori për Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit
Vendi i punës	Komuna e Vushtrrisë
Nr. i Referencës	RN00013333
Kodi	RPC0006872



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësive dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Bën projektimin, zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve dhe bazave të të dhënave për të dhënat gjeohapësinore,
- Ndihmon në përgatitjen e dokumenteve me rëndësi për planifikim hapsinor duke ofruar të dhëna nga sistemi GIS.
- Standardizimi i të dhënave gjeografike
- Bashkëpunon me njësitë tjera të komunë me qëllim të mbledhjes së të dhënave inxhinierike dhe të dhënave tjera për t'i evidentuar në sistemin GIS.
- Administron me bazën e të dhënave të GIS dhe përditëson të dhënat në data bazë,
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi nga fushë veprimtaria dhe kompetencat e njësive dhe përgatitja profesionale;

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Drejtimi Hartografi, GIS dhe Gjeografi.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Të jetë i certifikuar për GIS;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore- **(Diplomat e lëshuara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas ligjeve në fuqi);**
- Kopja e letërnjoftimit;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit **(e dokumentuar me trust pensional);**
- Vërtetimin për zotësinë e plotë të veprimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Certifikatën nga Gjykata (origjinali) - **(pas pranimit në punë);**
- Certifikatën shëndetësore - **(pas pranimit në punë);**
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende **(nëse aplikuesi ka punuar ose punon në institucione publike).**

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 30/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

Të jetë i certifikuar në GIS;

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Udhëzim për aplikim; Bashkangjitur keni linkun në youtube për mënyrën e aplikimit përmes sistemit - platformës;

<https://konkursi.rks-gov.net/https:>

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

